



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 1 Gusht 2016
Nr. ref.: RK 969/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastet nr. KI140/15, KI28/16, KI35/16, KI36/16, KI48/16,
KI49/16, KI52/16, KI53/16 dhe KI56/16**

Parashtrues

**Dukagjin Beqa, Tasim Kurti, Musa Berisha, Xhavit Ibrahim, Lirije Zalli,
Nevime Sahatqia, Teuta Muhaxhiri, Arif Karakushi dhe Bedri Bokshi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0117,
të 9 nëntorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë dorëzuar nga: kërkesa nr. KI140/15 nga Dukagjin Beqa; kërkesa nr. KI28/16 nga Tasim Kurti; kërkesa nr. KI35/16 nga Musa Berisha; kërkesa nr. KI36/16 nga Xhavit Ibrahim; kërkesa nr. KI48/16 nga Lirije Zalli; kërkesa nr. KI49/16 nga Nevime Sahatqia; kërkesa nr. KI52/16 nga Teuta Muhaxhiri; kërkesa nr. KI53/16 nga Arif Karakushi; dhe kërkesa nr. KI56/16 nga Bedri Bokshi, të gjithë nga Gjakova (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0117 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), të 9 nëntorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, janë shkelur nenet 3 [Barazia para Ligjit], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i dispozitave për të Drejtat e Njeriut], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 5 [E drejta për liri dhe siguri] dhe 6 [E drejta për gjykim të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesat bazohen në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 nëntor 2015, parashtruesi, Dukagjin Beqa, dorëzoi kërkesën nr. KI140/15, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 13 janar 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin Dukagjin Beqa, në rastin KI140/15, për regjistrimin e kërkesës dhe ka kërkuar nga ai që ta plotësojë formularin e Gjykatës dhe ta dorëzojë në Gjykatë vendimin e kontestuar.
8. Më 9 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës, Tasim Kurti, dorëzoi kërkesën nr. KI28/16 në Gjykatë.
9. Më 10 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës, Dukagjin Beqa, dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të Gjykatës dhe dokumentet shtesë.
10. Më 18 shkurt 2016, Gjykata ia dorëzoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

11. Më 19 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës, Musa Berisha, dorëzoi kërkesën nr. KI35/16 në Gjykatë.
12. Më 19 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës, Xhavit Ibrahim, dorëzoi kërkesën nr. KI36/16 në Gjykatë.
13. Më 3 mars 2016, parashtruesja e kërkesës, Lirije Zalli, dorëzoi kërkesën nr. KI48/16 në Gjykatë.
14. Më 7 mars 2016, parashtruesi i kërkesës, Tasim Kurti, dorëzoi dokumentet shtesë në Gjykatë.
15. Më 8 mars 2016, parashtruesja e kërkesës, Nevime Sahatqia, dorëzoi kërkesën nr. KI49/16 në Gjykatë.
16. Më 8 mars 2016, parashtruesja e kërkesës, Teuta Muhaxhiri, dorëzoi kërkesën nr. KI52/16 në Gjykatë.
17. Më 8 mars 2016, parashtruesi i kërkesës, Arif Karakushi, dorëzoi kërkesën nr. KI53/16 në Gjykatë.
18. Më 8 mars 2016, parashtruesi i kërkesës, Bedri Bokshi, dorëzoi kërkesën nr. KI56/16 në Gjykatë.
19. Më 25 mars 2016, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës ka urdhëruar bashkimin e kërkesës KI140/15 me kërkesat KI28/16, KI35/16, KI36/16, KI48/16, KI49/16, KI52/16, KI53/16 dhe KI56/16. Me këtë urdhër është vendosur që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues në të gjitha kërkesat të jenë të njëjtë ashtu siç ishte vendosur me Vendimin KI140/15.
20. Më 8 prill 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe informoi Gjykatën Supreme të Kosovës për bashkimin e kërkesave, ndërkohë kërkoi nga Gjykata Supreme e Kosovës ta dorëzojë informatën për datën se kur i është dorëzuar parashtruesit Bedri Bokshit vendimi i kontestuar.
21. Më 15 prill 2016, Gjykata Supreme ia dorëzoi Gjykatës fletëkthesat me të cilat dëshmon se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar avokatëve të parashtruesve më 19 nëntor 2015.
22. Prandaj, Gjykata konstaton se secili prej parashtruesve të kërkesës dorëzuan kërkesat në Gjykatë brenda afatit prej 4 (katër) muajve siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
23. Më 13 qershor 2016, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

24. Secili nga parashtruesit e kërkesës pretendon se në vitin 1994 atyre u është dhënë individualisht pronësia e një parcele toke për shfrytëzim të përhershëm

nga Kombinati Bujqësor Industrial “Ereniku” në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: KBI “Ereniku”) për të cilën organizatë ata punonin.

25. Më 7 qershor 2003, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë për vërtetimin e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme që është objekt shqyrtimi i kërkesave të tyre në këtë Gjykatë.
26. Më 11 gusht 2004, Gjykata Komunale në Gjakovë e shpalli veten jokompetente lëndore për të vendosur mbi këtë çështje juridike.
27. Më 21 prill 2006, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i specializuar) për vërtetimin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme.
28. Parashtruesit e kërkesës në padinë e tyre pretendojnë se kanë punuar për një kohë të gjatë në KBI “Ereniku” në Gjakovë, i cili ishte integruar me Kombinatin Bujqësor Beograd Prodhimtari Primare (në tekstin e mëtejshëm: PKB Prodhimtaria Primare) me seli në Padinska Skela në Beograd.
29. Parashtruesit e kërkesës në padinë e tyre pretendojnë se PKB Prodhimtaria Primare (Vendimi nr. 5346, të 23 shtatorit 1994), punëtorëve të kombësisë serbe dhe shqiptare u ka dhënë në shfrytëzim të përhershëm 33 (tridhjetë e tre) parcela ndërtimore. Këto parcela ishin regjistruar në fletën poseduese të KBI “Ereniku” në Gjakovë.
30. Parashtruesit pretendonin që pëlqimi i Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë kërkohej para se bartja e tentuar të mund të ishte e vlefshme në pikëpamje ligjore. Ai pëlqim kërkohej sipas Ligjit të atëhershëm të aplikueshëm mbi kushtet e veçanta të bartjes së pronës së patundshme, i cili u botua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë, Nr. 30, 89, 42/89, 22/91, për bartjen e pronësisë së pasurive të paluajtshme.
31. Për më tepër, parashtruesit në padinë e tyre kishin theksuar se pëlqimi i ishte dhënë të gjithë punëtorëve të kombësisë serbe, të cilët atë pasuri të paluajtshme e regjistruan në kadastër në emrin e tyre me kontratat që janë vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë; megjithatë, asnjë punëtor i kombësisë shqiptare nuk kishte marrë pëlqim për bartjen e pronësisë së pasurisë së paluajtshme. Parashtruesit pohojnë se trajtimi i ndryshëm në lidhje me pëlqimin ishte një rast klasik i diskriminimit në baza etnike.
32. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se Ligji mbi kushtet e veçanta të bartjes së pronës së paluajtshme, që ishte i aplikueshëm në atë kohë, ka qenë diskriminues dhe se menjëherë pas luftës u anulua nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.
33. Parashtruesit e kërkesës në padinë e tyre kërkojnë që Kolegji i specializuar të konfirmojë se çdo njëri prej tyre është pronar i ngastrave ndërtimore që janë të regjistruara në fletën poseduese të KBI “Ereniku” në Gjakovë, si dhe kërkojnë nga Kolegji i specializuar që ta detyrojë KBI “Ereniku” t’ua njohë atyre këtë të drejtë të pronësisë.

34. Më 13 shtator 2006, Kolegji i specializuar (Aktvendimi SCC- 07-0111) dërgoi në kompetencë këtë çështje juridike në Gjykatën Komunale në Gjakovë dhe urdhëroi si në vijim:
1. Çështja juridike i përcillet Gjykatës Komunale në Gjakovë,
 2. Në rast ankese, ajo duhet të depozitohet pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,
 3. Ky aktvendim është përfundimtar, ligjërish i detyrueshëm dhe pa të drejtë ankese”.
35. Më 28 shtator 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë (Aktgjykimi C. nr. 639/06) e hodhi poshtë si të pabazuar padinë e parashtruesve të kërkesës, duke gjetur *“së paditësit me asnjë bazë për fitimin e të drejtës të pronësisë nuk e kanë fituar të drejtën e pronësisë në pjesët e pasurive të paluajtshme të përmendur”*.
36. Gjykata Komunale në Gjakovë (Aktgjykimi C. nr. 639/06) fillimisht ka cekur se sipas nenit 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore të Jugosllavisë, e drejta e pronësisë mund të fitohet: 1) në bazë të punës së vlefshme juridike, 2) trashëgimisë, dhe 3) me vendimin e organit qeveritar.
37. Për më tepër, Gjykata Komunale në Gjakovë arsyetoi se e drejta e pronësisë nuk është fituar në bazë të punës së vlefshme juridike për shkak se *“... PKB “Prodhimtaria Primare” [...] me seli në Padinska Skela, nuk ishte entitet ekonomik që ishte në gjendje ta ndajë pasurinë e paluajtshme për të cilën paditësit pretendojnë se i kanë fituar të drejtën e pronësisë, për shkak se prona e paluajtshme, përkatësisht ngastrat kadastrale nr. 514/1 dhe 515/1 është e regjistruar në emër të KBI-së “Ereniku” në Gjakovë [...]”*.
38. Përveç kësaj, Gjykata Komunale në Gjakovë thekson se *“... rezulton se paditësit nuk kanë fituar të drejtën e pronësisë nga asnjë nga bazat e parashikuara me nenin 20, paragrafi 1 të dispozitave të lartpërmendura, e as nga paragrafi 2 i këtij ligji, për shkak se vendimi i Bordit Drejtues të PKB “Prodhimit Fillorë” [...] nuk ka cilësinë e vendimit të autoritetit publik në bazë të të cilit paditësit do të mund të fitojnë të drejtën e pronësisë”*.
39. Gjykata Komunale në Gjakovë më tej shqyrtoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës se kundër tyre është bërë diskriminimi dhe konkludoi si në vijim:
- “Pretendimi i autorizuesit të paditëseve që Ministria e Financave - Departamenti për Marrëdhënie juridiko/pronësore nuk e ka aprovuar kërkesën që paditësit t'i lejohet lidhja e kontratës për të siguruar shfrytëzimin e pjesëve të pasurive të paluajtshme mbi ngastrat kadastrale, dhe se ajo i diskriminoi paditësit mbi baza etnike, sepse janë shqiptarë, nuk është aspak kontestuese, megjithatë, kjo nuk është bazë për fitimin e të drejtës pronësore, siç u përmend më lart”*.
40. Gjykata Komunale në Gjakovë ka arsyetuar edhe kushtet e veçanta të tjetërsimit të pronës shoqërore si në vijim:

“Në bazë të dispozitave të nenit 247 të Ligjit për punën e bashkuar... parashihet që gjërat që janë mjete të prodhimit dhe mjete të tjera të punës, si dhe mjetet e përdorimit të përbashkët nuk mund të tjetërsohen nga prona shoqërore pa kompensim, përveç në rastet e përcaktuara me ligj [...], ndërsa në nenin 249 të të njëjtit ligji parashikohet se dispozitat e kontratës që janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 247 dhe 248 të këtij ligji janë null ...”.

41. Parashtruesit e kërkesës paraqitën një numër të madh të ankesave individuale në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë.
42. Më 24 nëntor 2014, Agjencia Kosovare e Privatizimit parashtroi përgjigje kundër çdo ankese të parashtruesve. Si përgjigje Kolegji i Apelit vendosi që të gjitha rastet t'i bashkojë në një, me numër (AC-II-12-0117).
43. Më 9 nëntor 2015, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi AC-II-12-0117) i refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin (C. nr. 639/06) e Gjykatës Komunale në Gjakovë, duke arsyetuar:

“Kolegji i Apelit konsideron se Gjykata Komunale drejt ka konstatuar se vendimi i Bordit Drejtues nuk mund të cilësohet si vendim i organit shtetëror. Përkundrazi, konstatoi se vendimi për miratimin e bartjes së pasurive të paluajtshme nuk është marrë nga mbajtësi i së drejtës të pronësisë, KBI “Ereniku”, Gjakovë, por nga një tjetër KBI me seli në Padinska Skela i cili nuk ishte pronar i pronës.

Prandaj, Kolegji i Apelit pas shqyrtimit të çështjes, pretendimeve lidhur me mënyrën e fitimit të pronës, duke u bazuar në vendimin e Bordit Drejtues të KBI-së, ka gjetur se një mënyrë e tillë e fitimit të pronës nuk është në pajtim me kriteret dhe mënyrën siç kërkohet nga ligji i aplikueshëm për bartjen e pronave shoqërore”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

44. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në procedurat në gjykatat e rregullta janë shkelur një numër i neneve të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.
45. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjendja faktike është “kryesisht e qartë”, por se gjykata e shkallës së parë e refuzoi kërkesën e parashtruesve “duke aplikuar ligjet e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë”, të cilët, sipas pretendimeve të parashtruesve nuk ishin dashur të jenë të aplikueshëm, për shkak se janë në kundërshtim me shumë nene të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.
46. Si përfundim, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se “Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me Ligjin kundër diskriminimit - Ligji nr. 2004 /3, i 19 shkurtit 2004. [...] Veprimi i Gjykatës së shkallës së parë është diskriminimi i drejtpërdrejt në bazë të përkatësisë kombëtare. Këta punëtorë kanë qenë të diskriminuar në kohën e regjimit serb, por ky diskriminim është

realizuar edhe tash me Aktgjykimin e atakuar, në kohën e lirisë dhe të ç'fuqizimit të sistemit diskriminator dhe segregacionist”.

47. Parashtruesit kërkojnë: “...që Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-II-12-0117 dt. 9.11.2015 të PRISHET, të ANULOHE, të shpallet i kundërligjshëm dhe kundërkushtues, kundër të gjitha dokumenteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare (...)”.

Pranueshmëria e kërkesës

48. Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

50. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Në kërkesën e tij/saj, paditësi duhet saktësisht të qartësoj se cilat të drejta dhe liri ai/ajo pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

51. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

52. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk shpjegojnë se si gjoja janë shkelur nenet e caktuara të Kushtetutës, por ata thjesht konstatojnë se ishin diskriminuar në procedurën në gjykatat e rregullta, dhe se ishin aplikuar “ligjet e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë”, të cilat nuk është dashur të

aplikohen për shkak se ato janë në kundërshtim me një numër të neneve të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare aplikimi i të cilëve drejtpërdrejtë parashihet me Kushtetutë.

53. Në esencë, të gjitha pretendimet e parashtruesve të kërkesës mund të përmbliidhen në:

- (i) Shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera;
- (ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera;
- (iii) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera;
- (iv) Shkeljet e pretenduara të nenit 3, 21, 22, 23 dhe 53 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera.

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera

A. Parimet e përgjithshme në lidhje me diskriminimin

54. Gjkata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thekson se *“diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme”* (Shih, *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 11 shtatorit 2002, dhe *Bekos Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, të 13 marsit 2006).
55. Në mënyrë që pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në lidhje me shkeljen e të drejtës për diskriminim të mund të jetë e suksesshme, ata, *inter alia*, duhet të dëshmojnë se pozita e tyre mund të konsiderohet e ngjashme me pozitën e një personi tjetër i cili ka pasur trajtim më të mirë (Shih, *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60 i Aktgjykimit të KEDNJ-së të 18 shkurtit 1991).

B. Aplikimi i parimeve të lartpërmendura në këtë rast konkret

56. Gjkata vëren se Gjkata Komunale në Gjakovë mori parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me diskriminimin në baza nacionale nga Ministria e Financave të Republikës së Serbisë. Në të vërtetë, Gjkata Komunale konsideroi se:

“Pretendimi i autorizuesit të paditëseve që Ministria e Financave - Departamenti për Marrëdhënie juridiko/pronësore nuk e ka aprovuar kërkesën që paditësit t’i lejohet lidhja e kontratës për të siguruar përdorimin e pjesëve të pasurive të paluajtshme mbi ngastrat kadastrale, dhe se ajo i diskriminoi paditësit mbi baza etnike, sepse janë shqiptarë, nuk është aspak kontestuese, megjithatë, kjo nuk është bazë për fitimin e të drejtës pronësore, siç u përmend më lart”.

57. Megjithatë, Gjkata Komunale në Gjakovë konstatoi se të gjitha kontratat, pavarësisht nëse i kishin lidhur punëtorët e kombësisë shqiptare ose serbe

“nuk paraqesin sipas vlerësimit të kësaj gjykate bazë për fitimin e të drejtës së pronësisë”. Gjykata Komunale në Gjakovë, më tej, arsyetoi:

“... Gjykata konstaton se “PKB “Prodhimtaria Primare” [...] me seli në Padinska Skela, nuk ishte entitet ekonomik që ishte në gjendje të ndajë pasuri të paluajtshme për të cilat paditësit pretendojnë se i kanë fituar të drejtën e pronësisë, për shkak se prona e paluajtshme, përkatësisht ngastra kadastrale nr. 514/1 dhe 515/1 është e regjistruar në emër të KBI-së “Ereniku” në Gjakovë [...]”.

58. Nga të gjitha që u thanë më lart, Gjykata Komunale në Gjakovë nuk ka mundur t'i anulojë kontratat që i kishin lidhur punëtorët e nacionalitetit serb, për shkak se këto kontrata nuk ishin objekt i kontestit në Gjykatën Komunale në Gjakovë. Gjykata konstatoi se ka pasur diskriminim të cilin gjykata, por se nuk ka mundur ta korrigjojë për shkak se atë nuk e kanë bërë autoritetet publike të Republikës së Kosovës.
59. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për diskriminimin e bërë nga Gjykata Komunale në Gjakovë dhe autoritetet tjera publike të Republikës së Kosovës janë të pabazuara, sepse nuk kishin “bërë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, ndaj personave në situata të ngjashme”.

(ii) Shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenet tjera

A. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën në pronë

60. Gjykata rikujton parimet e përgjithshme të përcaktuara me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, të cilat janë të aplikueshme edhe me nenin 46 të Kushtetutës dhe e arsyetojnë fushën e mbrojtjes së të drejtës në pronë (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 35 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004, *MALTZAN (FREIHERR VON) dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, paragrafi 74, Vendimi i KEDNJ-së për pranueshmëri i 2 marsit 2005).
61. Parimet e përgjithshme janë si në vijim:
- a) Privimi i pronësisë apo të një drejtë tjetër *in rem* në parim është akt i menjëhershëm dhe nuk prodhon gjendje të përhershme të “privimit të së drejtës” (Shih, *Malhous kundër Republikës Çeke*, Aktgjykimit i GJEDNJ-së, të 12 korrikut 2001).
 - b) Neni 1 i Protokollit nr. 1 nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së të 9 tetorit 2003).
 - c) Parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 vetëm për atë sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me “pronën” e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite “pronë” mund të

jetë “pasuri ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të cilave parashtruesi mund të pretendoj “*pritshmëri legjitime*” që do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës së njëjtë. Në të kundërtën, shpresa në njohje të të drejtave të pronësisë që ishte e pamundur për të realizuar në mënyrë efektive nuk mund të konsiderohet si “pronë” brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1, as një kërkesë kushtimore që pushon të jetë e vlefshme si rezultat i mospërmbljes së kriterëve (Shih, *Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë*, paragrafët 82 - 83, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, të 12 korrikut 2001, dhe *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, paragrafi 69, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë, të 10 korrikut 2002).

- d) Nuk mund të thuhet se lind ndonjë “*pritje legjitime*”, atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesat e parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50, i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004).

B. Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret

62. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk janë bartësit e së drejtës pronësore. Përkundrazi, ata provuan ta fitojnë pronën, do të thotë që parashtruesit kishin vetëm atë që kishte thënë Gjykata Themelore: “...shpresë për njohjen e të drejtave pronësore, e cila ishte e pamundur të arrihet efektivisht...”. Kështu që kjo gjendje e tillë reale nuk mund të konsiderohet si pronë në posedim në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1”.
63. Të gjitha “*pritjet legjitime*” të parashtruesve se ata do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronës ishin të bazuara në vendimin e organit të PKB Prodhimtaria Primare për të cilin Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë konstatuar se “*nuk ishte pronari i pronës*”, dhe se “*mbajtësi i të drejtës pronësore ishte NSH “Erenik”*”.
64. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Gjakovë konstatoi se “*paditësit nuk e kishin fituar të drejtën e pronësisë për as një nga bazat e parashikuara me nenin 20, paragrafi 1, i dispozitës të lartpërmendur, e as sipas paragrafit 2 të këtij ligji.*”
65. Nga ajo që është thënë më lart, Gjykata rikujton se “*pritshmëria legjitime*” e të drejtës në pronë nuk mund të ndodhë “*në qoftë se ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit të brendshëm*”. Në bazë të të gjithave që u prezantuan Gjykata konkludon se me vendimet e gjykatave të rregullta nuk është shkelur neni 46 i Kushtetutës as neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

(iii) Shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenet tjera

66. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me nenet tjera të përmendura.
67. Parashtruesit pretendojnë se *“...ka pasur aplikim të gabuar të drejtës materiale dhe procedurale ashtu që gjykatat e rregullta aplikuan ligjet e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të cilat, sipas parashtruesve nuk ishin dashur të aplikohen”*, Prandaj, ata konkludojnë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.
68. Gjykata përsëritë që nuk është funksion i Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e pretenduara të aplikimit të ligjeve përkatëse që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, nëse me këtë aplikim nuk janë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, paragrafi 28, Aktgjykimi i GJEDNJ i 21 janarit 1999).
69. Sidoqoftë, është detyrë e gjykatave të rregullta t'i zgjidhin çështjet e interpretimit të ligjit. Kjo veçanërisht vlen për aplikimin dhe interpretimin e ligjeve përkatëse nga ana e gjykatave të rregullta të së drejtës materiale dhe procedurale (Shih: *Pekinel kundër Turqisë*, paragrafi 53, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, të 18 marsit 2008). Roli i Gjykatës është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në pajtim me Kushtetutën në tërësi dhe me parimin e sigurisë juridike, veçanërisht ato të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
70. Gjykata konsideron se Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Kolegji i Apelit dhanë përgjigje të arsyeshme në pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me arsyet për aplikimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.
71. Gjykata vëren se *çështja kryesore që u ngrit në gjykatat e rregullta ishte çështje e “bazës ligjore për fitimin e së drejtës pronësore”*, në të cilin Gjykata Komunale në Gjakovë (Aktgjykimi C. nr. 639/06), arsyetoi se në rastin konkret aplikohet neni 20, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore të Jugosllavisë (botuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së nr. 6 të 8 shkurtit 1980), dhe sipas vlerësimit të gjykatës, vendimi (nr. 5346 i 23 shtatorit 1994) i Bordit Drejtues i PKB “Prodhimtaria Primare nuk paraqet bazë ligjore *“...për fitimin e së drejtës pronësore”*.
72. Një përfundim i tillë është mbështetur nga Gjykata Komunale dhe Kolegji i Apelit (Aktgjykimi AC-II-12-0117), i cili më tej *“konstatoi se vendimi për aprovimin e bartjes të kësaj pasurie të paluajtshme nuk është marr nga mbajtësi i së drejtës pronësore, KBI “Ereniku”, Gjakovë, por nga një tjetër KBI me seli ne Padinska Skela i cili nuk ishte pronar i pronës.”*
73. Parashtruesit kontestojnë aplikimin e ligjeve përkatëse dhe interpretimin e tyre nga ana e gjykatave të rregullta. Këtë interpretim e kanë arsyetuar gjykatat e rregullta në dy shkallë. Ky përfundim u arrit nga gjykatat e rregullta pas një

shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesit e kërkesës.

74. Parashtruesve të kërkesës u është dhënë mundësia në fazat e ndryshme të procedurave t'i paraqesin argumentet dhe provat që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre. Njëkohësisht, atyre u është dhënë mundësia për të kontestuar në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare dhe ta kontestojnë interpretimin e ligjit në Gjykatën Komunale në Gjakovë dhe Dhomën e Apelit në procedurë të rregullt gjyqësore.

75. Gjykata konsideron se kriteret e pranueshmërisë nuk janë përmbushur. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur dhe mbështetur pretendimet se me vendimin e kontestuar u janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

(iv) Shkeljet e pretenduara të nenit 3, 21, 22, 23 dhe 53 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të KEDNJ-së në lidhje me nenet e tjera.

76. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës i referohen edhe shkeljes së nenit 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës dhe nenin 5 [E drejta për liri dhe siguri] të KEDNJ-së, të cilët garantojnë se *"Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetent"*.

77. Gjykata konsideron se këto dy nene nuk janë të aplikueshme në këtë rast, sepse asnjë nga parashtruesit nuk ishte ndaluar apo në ndonjë mënyrë privuar nga liria, kështu që, Gjykata nuk do t'i shqyrtojë shkeljet e pretenduara të këtyre neneve.

78. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës i referohen edhe shkeljes së nenit 3 [Barazia para Ligjit], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

79. Parashtruesit nuk e shpjegojnë në mënyrë të veçantë se si janë shkelur secili prej këtyre neneve dhe të këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare; ata vetëm përmendin këto nene dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

80. Gjykata konsideron se nuk ka nevojë të shqyrtohen këto pretendime, sepse parashtruesit kërkesës nuk kanë dëshmuar se si këto nene ndikojnë në të drejtat e tyre themelore në këtë rast konkret.

81. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtruesve të kërkesës, të cilat ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ata e kontestojnë janë prezantuar në detaje dhe, se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta.

82. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub

kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë, të 30 qershorit 2009).

83. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se parashtuesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur dhe dëshmuar pretendimet e tyre. Prandaj, kërkesat e tyre janë të papranueshme, si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit, dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 13 qershor 2016, me shumicë

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Robert Carolan



Arta Rama-Hajrizi